



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi		Datë: 18.12.2018	Numri i seancës për këtë çështje: 1
Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut"- projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).			
A. Informacioni bazë			
Institucioni dhe tema	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, seanca dëgjimore e subjektit të rivlerësimit		
Emri i subjektit të rivlerësimit	Alfred Progonati		
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme. Vlerësimi i këtij subjekti kryhet në bazë të shortit.		
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	Seanca u shty për dhënien e vendimit për në datë 20 Dhjetor, ora 10:00, dhe trupi gjyqës nuk paraqiti asnjë arsye për këtë shtyrje.		
lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur	Vendimi nuk u shpall në përfundim të seancës dëgjimore, në kundërshtim me nenin 55 pika 6 të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve".		
B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca			
Trupi gjyqës (emrat)	Genta Tafa, kryesuese, Pamela Qirko, relatores, Xhensila Pine, anëtare.		
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	Znj. Marie Tuma		
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	Subjekti u mbrojt personalisht përpara Komisionit të Pavarur të Kualifikimit		
Anëtare të tjere të publikut të pranishëm?	10 anëtarë nga publiku. Seanca u monitorua edhe nga një vëzhgues i Avokatit të Popullit.		
Media e pranishme:	Në sallën ku u zhvillua seanca dëgjimore u vu në një numër i vogël i përfaqësuesve të medias. Kështu, seanca u monitorua nga përfaqësues të medias së shkruar, (BIRN, dhe Gazeta Shekulli) dhe u vërejt operator i medias që të kryente video regjistrimin e çeljes së seancës dëgjimore.		
C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?	Po	Nëse po, si u justifikua ai?	Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?
	Rivlerësimi i këtij subjekti u krye mbi bazën e të tri kriterëve të vlerësimit.		
D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kriterëve)	Argumenti	Kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?
D1. Pasuria	<p>Lidhur me vlerësimin e pasurisë, ILDKPKI i ka konstatuar pozitivisht se subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar pasurinë dhe nuk ka qenë në gjendje të konfliktit të interesit.</p> <p>Relatorja u shpreh se pas hetimit të plotë dhe të gjithanshëm të kryer nga KPK rezultoi se subjekti ka pasuritë e mëposhtme:</p> <p>1. Apartament 126 m2 në Rr. "X. Y" Tiranë, e blerë në vitin 2005 në vlerën 70 mijë Euro. Lidhur me burimin e të ardhurave për blerjen e saj subjekti ka deklaruar: i. nga shitja e banesës së tij në Tepelenë plus garazhin, të dyja së bashku në vlerën 2 milion Lekë; ii. kursimet e tij dhe të bashkëshortes së tij deri në vitin 2004. (me këto dy të parat ka paguar një pjesë të çmimit prej 41 mijë Euro). iii. kredi në shumën 31 mijë Euro, me të cilën ka paguar diferencën e çmimit dhe i ka ngelur një tepëricë prej 500,000 Lekësh. Lidhur me këtë pasuri KPK ka konkluduar se subjekti ka pasur burime të ligjshme për blerjen e saj.</p> <p>2. Makinë tip "Toyota" e blerë në vitin 2014 në vlerën 3,360 Euro me të ardhura nga kursimet dhe nga paga. KPK është shprehur se rezultoi se në vitin 2014 ai kishte gjendje kesh 400,000 Lekë kursime nga paga, dhe 500,000 mijë Lekë të mbetura nga kredia e marrë në bankë. Edhe lidhur me këtë pasuri KPK ka konkluduar se subjekti ka pasur burime të ligjshme për blerjen e saj.</p> <p>3. Shpenzimet 8,600 Euro për shkollimin e së bijës në Gjermani. Për këto shpenzime subjekti ka deklaruar si burim: i. kursimet e akumuluar nga paga e tij dhe e gruas ndër vite; ii. të ardhurat nga puna e së bijës në Gjermani, ku ai ka paraqitur dokumente se ajo kishte fituar 5,200 Euro për vitet 2016 dhe 2017. iii. kredi konsumatorë prej 1500 Eurosh. Edhe lidhur me këtë pasuri KPK ka konkluduar se subjekti ka pasur burime të ligjshme për blerjen e saj.</p> <p>Nga analiza financiare KPK deklaroi se nga analiza financiare për 2014 balanca ka dalë negative, me -92,000 mijë Lekë. Për këtë, subjektit i ka kaluar barra e provës i cili ka shpjeguar se është pasojë e një gabimit të llogaritjes së konvertimit të Euros në Lekë. Si përfundim KPK ka konkluduar se do të vlerësonte shpjegimet e subjektit me objektivitet.</p>	<p>ILDKPKI</p> <p>Relatori</p>	<p>Barra e provës u kalua sipas ligjit</p>

	n/a	Mbrojtja	
	Subjekti u shpreh se ishte dakord me hetimet dhe konstatimet e KPK lidhur me pasurinë e tij, dhe se në lidhje me diferencën negative në vitin 2014 kishte paraqitur shpjegimin e tij të cilin e përsëriti edhe në seancë.	Subjekti	
	Asnjë	Ankesa nga publiku	
	Asnjë	ONM	
	DSIK ka paraqitur raport sipas ligjit dhe ka deklaruar <u>përshtatshmërinë</u> e subjektit për të vazhduar detyrën. KPK ka lënë në fuqi atë pas hetimit të saj të pavarur.	DSIK	
	Relatorja u shpreh se pas hetimit të plotë dhe të gjithanshëm të kryer nga KPK rezultoi se subjekti është i përshtatshëm për të vazhduar detyrën.	Relatori	
	n/a	Mbrojtja	
	Dakord me vlerësimin e KPK.	Subjekti	
	Asnjë	Ankesa nga publiku	
	Asnjë	ONM	
	Sipas raportit të Prokurorisë së Përgjithshme subjekti është vlerësuar <u>pozitivisht</u> për kriterin profesional.	Përgjithshme	
	Relatorja u shpreh se pas hetimit të plotë dhe të gjithanshëm subjekti është "i aftë".	Relatori	
	Dakord me vlerësimin e KPK.	Subjekti, etj..	
E. Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN, si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)	<p>Lidhur me parimin e publicitetit të seancës mbi hetimin e KPK</p> <p>Nga një analizë e thjeshtëzuar financiare në bazë të informacionit të marrë gjatë seancës gjyqësore rezultoi si më poshtë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Apartament 126 m2 në Rr. "X. Y" Tiranë, <p>Lidhur me këtë pasuri, KPK ka konkluduar pas pagesës së kështit të dytë që rezultoi të jetë në shumën 26 mijë Euro (67 mijë Euro -41 mijë Euro), dhe shpenzimeve për punimet shtesë prej 3 mijë Euro , diferenca e mbetur ka qenë 500,000 Lekë ndërkohë që kjo diferencë rezultoi të jetë 2,000 Euro. Nuk doli qartë pra llogaritja e kryer nga KPK.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Makinë tip "Toyota" <p>Lidhur me blerjen e kësaj pasurie në vitin 2014, siç shihet edhe në tabelën e mësipërme, bilanci rezultoi negativ, ashtu siç e ka konstatuar edhe KPK. Ndërkohë që nuk doli aspak e qartë gjatë seancës se si subjekti kishte provuar të kundërtën dhe mbi bazën e cilave të ardhura të dokumentuara ai kishte provuar burimet e ligjshme financiare për blerjen e saj.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpenzimet për shkollimin e të bijës në Gjermani. <p>Lidhur me këto shpenzime rezultoi përsëri një bilanc negativ në bazë të informacioneve të marra në seancë. Përveç kësaj, nuk doli e qartë se në cilën periudhë kohore u ngurtësuan 8600 eurot dhe cili ishte burimi i tyre i ligjshëm, në raport me kohën e marrjes së kredisë konsumatorë dhe realizimit të të ardhurave nga e bija në punësimin e saj në Gjermani. Përsëri nuk doli e qartë llogaritja e kryer nga KPK, veçanërisht të ardhurat nga pagat dhe kursimet e realizuara ndër vite pas shpenzimeve jetike.</p>		